

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim-vendosje motor i ri diesel, QSM11/WP 12 N, fuqi 276 kW, 6 cilindra, numri i rrotullimeve 2100 rpm, shpejtësia 600–1200 rpm, lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking per mjetin kompaktor YTO GROUP LLC 233H, viti i prodhimit 2011”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **KOMPAKTOR YTO, 43315000-4;**

Në mbështetje të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55 “Procedure e Hapur e Thjeshtuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IX “Rolet dhe Përgjegjësitë në Autoritetin/Entin Kontraktor”, Neni 73, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe urdhërit të prokurimit nr. 7, datë 19.02.2026 të Administratorit të Autoritetit Kontraktor “Bajkaj Land” sh.a, Njesia e Prokurimit e ngritur me urdhër nr. 3 datë 17.02.2026 “Për ngritjen e Njesisë së Prokurimit” mbledhur sot në datë 03.03.2026 mori në shqyrtim dokumentet e tenderit për objektin e prokurimit “Furnizim-vendosje motor i ri diesel, QSM11/WP 12 N, fuqi 276 kW, 6 cilindra, numri i rrotullimeve 2100 r/min, shpejtësia 600–1200 r/min, lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking per mjetin kompaktor YTO GROUP LLC 233H, viti i prodhimit 2011”

Për këtë, në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, u hap faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ku u morrën dokumentat standarte të tenderit dhe u plotësuan dokumentat e tenderit të mësipërm sipas Dokumentave Standarte të tenderit dhe u përgatiten për hedhjen në sistem.

1. Kërkesat e Përgjithshme për kualifikim të mbeten ato që përcaktohen në Dokumentat Standarte.
2. Kërkesat e veçanta për kualifikim të vendosen si më poshtë:
3. Për përllogaritjen e fondit limit **4,570,000 (kater milion e peseqind e shtatedhjetë mijë) leke pa tvsh.,** AK është bazuar në cmimin mesatar të cmimeve njësi marre nga sudimi i tregut në funksion të specifikës së pjeseve të kembimit dhe cmimet e tregut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Bajkaj Land” Sh.a ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk

ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**
- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor” duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, neni 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 të LPP, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **vërtetim për xhiron vjetore** për vitet financiare, **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur. **“Në rastin e bashkimit të operatoreve secili operator ekonomik duhet të dorëzojë këtë dokument” në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. **“Në rastin e bashkimit të operatoreve secili operator ekonomik duhet të dorëzojë këtë dokument”,** sipas të nenit 88, pika 3, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, **“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 2 (dy) vitet e fundit financiare, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur operatorët ekonomik ofertues janë në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika c, e ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur kur bilancet e dy viteve të

njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator ekonomik duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat pjesë kembimi si në objektin e prokurimit. Në rast se, do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton sigurinë e dorëzimit të mallit mbasi ofertuesi është i autorizuar për ofrimin e mallit nga prodhuesi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3.2 2 (dy) dëshmi për përvojën të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, ku në çdo rast vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe **të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe **të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.3 Listë të personelit kryesor (1 inxhinier mekanik, 1 specialist elektroaud dhe 1 mekanik), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Lista e personelit kryesor duhet të shoqerohet nga CV-të, diploma universitare, licencat profesionale, deshmi dhe kontrata pune gjate periudhes se kryerjes se sherbimit.

3 Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4/paragrafi 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 5/b,c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

3.3.1 Mjetet dhe pajisjet. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë paraprakisht duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Per kete duhet te vertetoje se ka të paktën:

- a) një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve të nevojshme gjatë periudhës së garancisë dhe magazine për pjesë këmbimi për llojin e pjesëve objekt i kësaj procedure prokurimi, me vendndodhje në Shqipëri, i regjistruar në ekstraktin e regjistrimit të regjistrimit të dhenat e subjektit ose në rast të marrjes me qera të paraqesë kontratë noteriale qeraje sipas Kodit Civil.
- b) një mjet transporti, të regjistruar në ekstraktin e regjistrimit të regjistrimit të dhenat e subjektit ose në rast të marrjes me qera të paraqesë kontratë noteriale qeraje sipas Kodit Civil. Në të dy rastet mjeti duhet të jetë i pajisur me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor të regjistruar në ekstraktin e QKB, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore në mbështetje të ligjit 8378 datë 22.07.1998 Kodi Rrugor, police për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësit të mjetit për përgjegjësi ndaj paleve të treta në mbështetje të dekretit nr 6077 datë 22.02.2009 dhe ligjit nr 10076 datë 12.02.2009. ***Ky dokumentacion do të paraqitet në rastin kur operatori ekonomik shpallet fitues.***
- c) Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e ministrisë së transportit dhe infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licensat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit ***Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike***. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të realizuar me sukses objektin të prokurimit, mbasi mjetet që disponon Autoriteti Kontraktor janë stacionare dhe nuk mund të dalin jashtë objektit, për shkak të specifikës së veprimtarisë që kryhet në landfillin Bajkaj.

3.3.2 Certifikatë Personale ISO 14001-2015 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të mjedisit dhe /ose të njëvlefshme ose standart ISO me të avancuar (e përkthyer e noterizuar), të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit dhe shërbimeve. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme, e përditësuar dhe e leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilat janë akredituar nga DPA ose nga

organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet të jete e përfshirë objekti i prokurimit. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3.3.3 Çertifikate Personale ISO 9001:2015, te standartit ndërkombëtar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevllefshme ose standart ISO me e avancuar (e perkthyer e noterizuar), te cilat do te garantonin cilesine e produktit dhe sherbimeve. Çertifikata duhet të jete e vlefshme, e perditësuar dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet të jete e përfshirë objekti i prokurimit. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3.3.4 Deklarate ku te specifikojë se malli, objekt i procedurës se prokurimit është **100% i ri, OEM dhe CPL ose ekuivalent,** me **0 orë pune,** origjinal.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

3.3.5 Deklarojë mallin që duhet të ofrohet sipas afateve te garancise te dhena nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Te dhenat teknike te mallit ne garanci te prodhuesit per kembim, i japin sigurine AK qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje kontraten sipas kushteve dhe kriterëve te percaktuara ne dokumentet e tenderit

Ligji i zbatueshëm për procedurën e prokurimit është Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 pika 3/b, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim

specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve: **Mjeti KOMPAKTOR qe disponon Autoriteti Kontartor eshte stacionare dhe nuk mund te dale jashte objektit, per shkak te specifikes se veprimtarise qe kryhet dhe ambjentit me ndotje ne venddepozitim e per kete i gjithe sherbimi do te behet ne Landfillin Bajkaj.**

Specifikimet teknike:

Per objektin e prokurimit “Furnizim-vendosje motor i ri diesel, QSM11/WP 12 N, fuqi 276 kW, 6 cilindra, numri i rrotullimeve 2100 r/min, shpejtësia 600–1200 r/min, lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking per mjetin kompaktor YTO GROUP LLC 233H, viti i prodhimit 2011” jane si ne tabelen me poshte: (Motor i RI diesel, OEM (Original Equipment Manufacturer), Cummins ose ekuivalent QSM11/WP 12 N, fuqi 276 kW, 6 cilindra, numri i rrotullimeve 2100 r/min, shpejtësia 600–1200 r/min, transmision hidrostatik me neutral braking, i kompletuar me turbokompresor, pompe naftë, injektorë, sistem ftohjeje, sistem vajosjeje, pajisje elektrike dhe sensorë, përfshirë të gjitha materialet, pajisjet, lubrifikantet, filtrat, montimin mekanik dhe elektrik, kalibrimin elektronik, testimin funksional dhe dorëzimin me procesverbal) specifikuar si ne tabelen me poshte:

Nr.	Karakteristikë	Vlerë / Përshkrim
1	Lloji i motorrit	Diesel 4-takt, OEM, CPL, plotësisht i RI (Brand New)
2	Prodhues	Cummins ose ekuivalent i tij
3	Model	QSM11/WP 12 N
4	Numri serial	numer serial unik i stapuar nga prodhuesi dhe se duhet te perputhet sakte me numrin ne CoC konform me modelin YTO LLC233H te mjetit
5	Fuqia	276 kW (-+3%)
6	Numri i cilindrave ne linje	6
7	Numri i rrotullimeve	2100 rpm
8	Shpejtësia operative	600–1200 rpm
9	Transmisioni	Hidrostatik me neutral braking
10	Pjesë kryesore të përfshira	Turbokompresor, pompa naftë, injektorë, sistem ftohjeje dhe vajosjeje, pajisje elektrike dhe sensorë
11	Materiale të përfshira	Lubrifikant (vajra), filtra
12	Shërbime të përfshira	Transport, montim mekanik dhe elektrik, kalibrim elektronik, testim funksional, dorëzim me procesverbal
13	Standart emetimesh	Jo me i ulet se standarti i motorrit original te instaluar ne mjet

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Malli Motor OEM Cummins QSM11 **ose ekuivalent** për mjet kompaktor YTO LLC 233H me specifikime si ne tabelen me siper, i kerkuar ne DST, te jete ne perputhje te plote me kerkesat dhe specifikimet, bazuar ne llojin dhe tipin e mjetit kompaktor, te cilat jane vendosur ne perputhje me manualet e operimit dhe mirembajtjes te vena ne dispozicion nga prodhuesi. Motori duhet të dorëzohet i **plotësisht i RI (Brand New)**, sipas CPL (Cummins Part List) ose **ekuivalent** me **numer serial unik te stampuar nga prodhuesi dhe se duhet te perputhet sakte me numrin ne CoC konform modelit te mjetit YTO LLC233H**. Motorri

te jete i gatshem per montim. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten per verifikim te numrit serial prane prodhuesit perpara pranimet final dhe se cdo ndryshim perben shkak per skualifikim. Te shoqerohet me manualin e mirembajtes dhe manualin teknik. Nuk pranohet motor i perdorur, i rindertuar (remanufactured) apo rikondicionuar.

Argumentimi: CPL (Cummins Part List) ose ekuivalent, sidomos kur bëhet fjalë për motorë industrialë OEM, mbasi **siguron që motori është origjinal dhe i kompletuar** – CPL tregon pjesët që përfshihen nga prodhuesi, **eliminon mundësinë që** operatori mund të dorëzojë motor jot e plote, pa pjesët kryesore dhe të pretenduar si “OEM” si dhe **lehtëson vlerësimin teknik** ku komisioni mund të kontrollojë përputhshmërinë me listën CPL dhe specifikimet OEM.

- Malli (motorr te dorëzohet **100% i ri, OEM dhe CPL origjinal**, me **0 orë pune**, original me **numer serial unik** nga prodhuesi, jo i rikondicionuar (remanufactured) apo i perdorur. I amballazhuar ku te identifikohen te gjitha specifikimet, marka, numri serial unik (ESN), i shoqeruar me certifikaten e origjines ose i konfirmuar per pershtatshmerine nga prodhuesi), CoC si dhe te kete te specifikuar te gjithë parametrat teknike ne treguesin e montuar ne motor. Shmangia nga OEM, CPL ekuivalent ose statusi “**I RI (Brand New)**” konsiderohet **mospërputhje teknike dhe shkak per skualifikim**.

Argumentim: Motor i ri, OEM, CPL qarteson se duhet te jete **original, te dorezohet i plote/I kompletuar dhe 100%/ I RI, i paperdorur; Numri serial dhe specifikimet teknike** saktësojnë motorin dhe përputhshmërinë me mjetin për verifikim pranë prodhuesit.

- Dorezimi mallit nga operatori ekonomik do te behet prane Autoritetit Kontraktor dhe i shoqeruar me dokumentacion **e detyrueshem per dorezimin e mallit** si ne table:

Nr.	Dokumenta te detyrueshme per dorezimin e mallit
1	Certifikatë origjine OEM
2	Certificate of Conformity (CoC)
3	CPL (Lista e Pjesëve Origjinale) ose ekuivalent
4	Deklaratë që motori është i RI (brand New) 0 orë pune , OEM
5	Garanci fabrike (12–24 muaj ose 2,000–4,000 orë pune)
6	Faturë furnizimi nga prodhuesi ose distributor i autorizuar
Shenim:	Mosparaqitja e dokumentacionit te dorezimit te mallit perben shkak per skualifikim

Mosparaqitja e dokumentacionit perben shkak per skualifikim. Me tej, do te vijohet me montimin ne mjetin kompaktor i cili ndodhet ne venddepozitim.

SASIA E MALLIT QË KËRKOHET DHE GRAFIKU I LËVRIMIT:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
	<i>mall / sherbim / pune</i>		
B	MJETI KOMPAKTOR MODEL LLC 233H, Vit prodhimi 2011,		
1	“Furnizim-vendosje motor i ri diesel, QSM11/WP 12 N, fuqi 276 kW, 6 cilindra, numri i rrotullimeve 2100 r/min, shpejtësia 600–1200 r/min, lloji i transisionit hidrostatik neutral braking per mjetin kompaktor YTO GROUP LLC 233H, viti i prodhimit 2011”	cope	1

Afatet e lëvrimit: 90 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
-----------	------------	-------	--------------	----------------------

A	MJETI KOMPAKTOR MODEL LLC 233H, Viti i prodhimit 2011, Motorr diesel "CUMMINS", model QSM11/WP 12N Nr. serial 71014905 dhe fuqi 276 kw.			
1	“Furnizim-vendosje motor i ri diesel, QSM11/WP 12 N, fuqi 276 kW, 6 cilindra, numri i rrotullimeve 2100 r/min, shpejtësia 600–1200 r/min, lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking per mjetin kompaktor YTO GROUP LLC 233H, viti i prodhimit 2011” i kompletuar me turbokompresor, pompe naftë, injektorë, sistem ftohjeje, sistem vajosjeje, pajisje elektrike dhe sensorë, përfshirë të gjitha materialet, pajisjet, lëngjet teknike, filtrat, montimin mekanik dhe elektrik, kalibrimin elektronik, testimin funksional dhe dorëzimin me procesverbal.”		“Bajkaj Land” Sh.a.	90 dite

Argumentim: Grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi, është hartuar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, i cili është në tabelën me sipër. Në grafikun e lëvrimit të mallrave dhe shërbimit është pasur parasysh natyra e mallit, mundësia e gjetjes në treg përfshirë vonesat e mundshme, magazinimi, montimi, testimi dhe dorëzimi dhe specifikisht nevoja urgjente për kthimin në kushte pune normale të mjetit Kompaktor në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Argumentimi i **afatit të dorëzimit dhe realizimit të kontratës specifikohet në tabelën me poshtë:**

Faza	Afati orientues
Konfirmimi i furnizimit	2 ditë
Porosia dhe furnizimi	2 jave (nëse motori është në stok) dhe 4 jave nëse duhet të prodhohet
Transport + dogana	4-5 jave duke përfshirë vonesat e mundshme
Çmontim i motorit ekzistues dhe përgatitje për vendosjen e motorit të ri	2 ditë
Montim mekanik dhe elektrik	3 ditë
Kalibrim elektronik dhe testim funksional	2 ditë
Dorëzim me procesverbal	1 ditë
Afati final	60-90 ditë nga nënshkrimi i kontratës duke marrë në konsideratë vonesa të mundshme të transportit ose prodhimit

GARANCIA: do të jetë nga prodhuesi për një afat 12-24 muaj ose 2000-4000 ore pune.

Element	Kohëzgjatja / Kushtet
Garancia nga prodhuesi/fabrika	12-24 muaj ose 2,000-4000 orë pune (kush mberrihet e para)
Përfshirja	Defekte të materialeve dhe prodhimit; riparim ose zëvendësim i pjesëve të dëmtuara gjatë periudhës së garancisë
Dokumentacion	Certifikatë garancie nga prodhuesi (OEM)

Shënim: Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të

kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Arianit Kendezi

Arkad Duka

Hyske Kuci